

Kronikë nga seanca 27-të

Shkup, 11.07.2019. – Në seancën e kaluar Këshilli i Agjencisë shqyrtoi raportin tremujor mbi punën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele për periudhën nga 1 Prilli deri më 30 Qershor 2019.

Bazuar në kërkesën e paraqitur nga TRD JON_RADIO SHPKPV Strugë, Këshilli i Agjencisë miratoi një vendim për zgjatjen e periudhës së fillimit të aktivitetit për transmetimin e një shërbimi programor.

Njëkohësisht, Këshilli i Agjencisë miratoi një Vendim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj kompanisë për prodhim, tregti dhe shërbime SPAJDER-NET import-eksport SHPK Gjevgjeli për shkak të ritransmetimit të shërbimeve të programit që nuk përfshihen në Regjistrin e lëshuar nga Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (neni 141 nga LSHMAAV).

Me qëllim të inicimit të procedurave që janë në përputhje me Planin Vjetor të Prokurimit Publik për vitin 2019 të Agjencisë, Këshilli miratoi Drejtorin e Agjencisë të kryejë procedurat e mëposhtme të prokurimit publik: në madh-veshje zyrtare, shërbime-mirëmbajtje dhe servisimi I ashensorëve dhe platforma shërbime hidraulike dhe elektrike.

Këshilli gjithashtu miratoi Vendim për aranzhimin e mjeteve financiare për rinovimin e 4(katër) aksesave të përdoruesit në bazë elektronike të dhëna në „Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.